



Raport i mbledhjes së të dhënave sasiore dhe cilësore në fazën e vlerësimit përfundimtar



RAPORT MBI TË DHËNAT SASIORE DHE CILËSORE

NË KUADËR TË PROGRAMIT RAJONAL NDAL DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE - ZBATOJMË STANDARDET, NDRYSHOJMË MENDËSITË”

Përgatitur nga:
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Mars, 2021

Ky raport është përgatitur nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në kuadër të programit Ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, “Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendësitë”, zbatuar nga UN Women dhe mbështetur nga Komisioni Evropian. Ky program rajonal synon të mbështesë zvogëlimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave në gjashtë shtete të Ballkanit perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi, Kosovë¹ dhe Serbi) dhe në Turqi.

Observatori u përzgjedh nga UN Women Shqipëri për *mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore mbi qëndrimet, perceptimet, opinionet dhe besimet publike aktuale dhe mbizotëruese ndaj barazisë gjinore (BGJ) dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave (DHnGV) dhe dhunës në familje (DHF) në nivel komuniteti*, gjatë tre fazave të ndryshme:

- Faza e parë: Vlerësimi fillestar (Baseline: nëntor 2017 - prill 2018)
- Faza e dytë: Vlerësimi afatmesëm (Mid-Term Review: shtator - dhjetor 2019)
- Faza e tretë: Vlerësimi përfundimtar (Endline: shtator 2020 – prill 2021)

Në këtë raport paraqiten gjetje sasiore dhe cilësore të mbledhura përgjatë fazës së vlerësimit përfundimtar. **Metodologjia** e ndjekur, e cila është një ndërthurje e qasjeve sasiore dhe cilësore, dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave janë siguruar nga UN Women, dhe janë unifikuar për të gjitha vendet zbatuese të programit rajonal. Mbledhja e të dhënave sasiore dhe cilësore u bë nëpërmjet mjeteve të kombinuara vijuese:

- **Anketa** – për mbledhjen e të dhënave sasiore mbi perceptimet dhe qëndrimet e burrave dhe grave lidhur me BGJ, DHnGV si dhe DHF. Plotësimi i pyetësorit për fazën e vlerësimit përfundimtar u realizua në periudhën *nëntor - dhjetor 2020*. Llogaritja e madhësisë së mostrës dhe diversifikimi i saj u bë në bazë të një niveli fiksis besimi prej 95%, në *gjini, moshë, vendndodhje*, si dhe në bazë të *përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar*, dhe *persona LGBTI*. Madhësia e mostrës për Shqipërinë është 1260 persona - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave 15 – 64 vjeç, në Qarkun e Elbasanit dhe bashkitë e Durrësit, Korçës, Shkodrës, Kamzës, Tiranës dhe Vlorës, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe *grupet e marginalizuara dhe vulnerabël* (Rome, Egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, dhe LGBTI), të cilët *përfaqësojnë 8% të kampionit*. Përzgjedhja e këtyre zonave u bazua në zbatimin e projekteve dhe ndërhyrjeve në këto zona nga pjesa tjetër e Organizatave Jo-Fitimprurëse (OJF), pjesë e programit rajonal të EU-UN Women. Analiza e të dhënave sasiore gjendet në pjesën e parë të këtij raporti.
- **Intervista të thelluara** – për mbledhjen e të dhënave cilësore për nismat e ndërmarra gjatë 4 viteve të fundit (2017-2020) në adresimin e stereotipeve gjinore dhe normave tradicionale, të cilat justifikojnë DHnGV dhe DHF, si dhe historive të suksesshme në adresimin e çështjeve të ndërgjegjësimit për DHnGV. Intervistat u realizuan me përfaqësues të 5 institucioneve dhe organizatave që kanë ndërmarrë nisma për BGJ, DHnGV dhe DHF përgjatë 4 viteve të fundit². Përzgjedhja e tyre u realizua me aprovimin e UN Women. Intervistat në fazën e vlerësimit përfundimtar u realizuan përgjatë muajit *shkurt 2021*. Analiza e të dhënave cilësore gjendet në pjesën e dytë të këtij raporti.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women apo të Komisionit Evropian.

¹ Çdo referencë ndaj Kosovës në këtë dokument, qoftë për territorin, institucione apo popullsinë do të kuptohet në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykimet për statusin e Kosovës.

² Lista e personave të intervistuar gjatë vlerësimit përfundimtar gjendet në Shtojcën A

TABELA E PËRMBAJTJES

I. TË DHËNAT SASIORE TË VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR MBI PROGRAMET E ZBATUARA NË FUSHËN E BGJ, DHnGV DHE DHF PËRGJATË VITEVE 2017-2020..... 4

1.1	Profili i zonave të projektit mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF.....	4
1.2	Profili i Bashkisë Durrës mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	5
1.3	Profili i Qarkut Elbasan mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF.....	6
1.4	Profili i Bashkisë Kamëz mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF.....	7
1.5	Profili i Bashkisë Korçë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	8
1.6	Profili i Bashkisë Shkodër mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF.....	9
1.7	Profili i Bashkisë Tiranë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF.....	10
1.8	Profili i Bashkisë Vlorë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF.....	11

II. TË DHËNAT CILËSORE TË VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR MBI PROGRAMET E ZBATUARA NË FUSHËN E BGJ, DHnGV DHE DHF PËRGJATË VITEVE 2017-2020..... 12

2.1	Grupet e synuara.....	12
2.2	Kanalet e informacionit.....	12
2.3	Metodat/ mjetet e përdorura	13
2.4	Monitorimi dhe vlerësimi i programeve.....	13
2.5	Eksperiencia nga zbatimi i programeve gjatë pandemisë globale Covid-19 (viti 2020).	14
2.6	Praktikat e suksesshme.....	16
2.7	Sfidat kryesore.....	17
2.8	Ndërhyrjet në të ardhmen në fushën e BGJ, DHnGV, DHF	18
2.9	Rekomandime për programet e ardhshme.....	18

III. SHTOJCA A: LISTA E PERSONAVE TË INTERVISTUAR..... 20

I. TË DHËNAT SASIORE TË VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR MBI PROGRAMET E ZBATUARA NË FUSHËN E BGJ, DHnGV DHE DHF PËRGJATË VITEVE 2017-2020

1.1 Profili i zonave të projektit mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 1260 individëve - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2020, në Qarkun e Elbasanit dhe bashkitë e Durrësit, Kamzës, Korçës, Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara - AK, dhe persona LGBTI).



Njohja e ligjit/ informacion rreth ligjit/ familjariteti me ligjin

- **65% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **81% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **36% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna psikologjike është e dënueshme me ligj.
- **69% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **28%** e të anketuarve besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **71% e të anketuarve nga komuniteti Rom/ Egjiptian** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
 - **13% e individëve me aftësi të kufizuara** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.

➤ 1 në 6 vajza/ gra të anketuara (16%) bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Në mes të vajzave/ grave të anketuarave Rome/ Egjiptiane ky besim është më i lartë, pasi pothuajse 1 në 3 të

- anketuara bie dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Ndërkohë 29% e djemve/ burrave kanë një qendrim të tillë.
- *Në lidhje me kontrollin mbi financa e grave*, 1 në 4 djem/ burra të anketuar; dhe 1 në 6 vajza/ gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 27.5% e djemve/ burrave të anketuar dhe 12.6% e vajzave/ grave të anketuara besojnë se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** Më shumë se treçetë e të anketuarve (78%) pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 20% e djemve/ burrave të anketuar dhe 31% e vajzave/ grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe BGJ

- Media sociale (50%), spotet televizive/ emisionet/ debatet (48%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (31%), dhe radio (20%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e DHnGV.

1.2 Profili i Bashkisë Durrës mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 176 individëve - gra, vajza, burra, djem, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2020, në bashkinë e Durrësit, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, AK)



Njohja e ligjit/ informacion rreth ligjit/ familjariteti me ligjin

- **71% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **97% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje (Bashkia me % më të lartë për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).
- **11% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna psikologjike është e dënueshme me ligj.
- **90% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet (Bashkia me % më të lartë për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).

Perceptimet e roleve gjinore

- **16%** e të anketuarve besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **67% e të anketuarve nga komuniteti Rom/ Egjiptian** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
 - **20% e individëve me aftësi të kufizuara** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
- 1 në 13 vajza/ gra të anketuara (8%) bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre, përkundrajt 11% të djemve/ burrave që kanë një qëndrim të tillë.
- Në lidhje me kontrollin mbi financa e grave, 1 në 8 djem/ burra të anketuar; dhe 1 në 7 vajza/ gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit (E vetmja Bashki me raportin më të lartë të vajzave/ grave që besojnë se të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit, në krahasim me djemtë/ burrat).

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 2.3% e djemve/ burrave të anketuar dhe 1.1% e vajzave/ grave të anketuara besojnë se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** 15% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 9% e djemve/ burrave të anketuar dhe 11% e vajzave/ grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI (Bashkia me % më të ulët të vajzave/ grave të gatshme për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe BGJ

- Media sociale (51%), spotet televizive/ emisionet/ debatet (34%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, radio (23%) dhe tabelat publicitare (18%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e DHnGV.

1.3 Profili i Qarkut Elbasan mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 248 individëve - gra, vajza, burra, djem, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2020, në Qarkun e Elbasanit në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, AK).



Njohja e ligjit/ informacion rreth ligjit/ familjariteti me ligjin

- **62% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **88% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **29% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna psikologjike është e dënueshme me ligj.
- **83% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **8% e të anketuarve** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **21% e të anketuarve nga komuniteti Rom/ Egjiptian** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
 - **Asnjë prej individëve me aftësi të kufizuara** nuk është shprehur që beson se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
- 1 në 18 vajza/ gra të anketuara (5.5%) bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre, përkundrajt 9% të djemve/ burrave

që kanë një qendrim të tillë.

- *Në lidhje me kontrollin mbi financa e grave*, 1 në 4 djem/ burra të anketuar; dhe 1 në 7 vajza/ gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 15.8% e djemve/ burrave të anketuar dhe 3.1% e vajzave/ grave të anketuara besojnë se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** 10% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Një pjesë e të anketuarve në këtë zonë ishin të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara.** Kështu 46% e djemve/ burrave të anketuar dhe 65% e vajzave/ grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI. (*Zona me % më të lartë të djemve/ burrave dhe vajzave/ grave të gatshme për parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI*, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe BGJ

- Media sociale (57%), spotet televizive/ emisionet/ debatet (53%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (47%), dhe radio (21%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e DHnGV.

1.4 Profili i Bashkisë Kamëz mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i **69 individëve** - gra, vajza, burra, djem, të moshave **15 – 64 vjeç**, përgjatë vitit **2020**, në **Bashkinë e Kamzës** në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (AK).



Njohja e ligjit/ informacion rreth ligjit/ familjariteti me ligjin

- **54% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **91% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **39% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna psikologjike është e dënueshme me ligj.
- **62% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **39%** e të anketuarve besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës, si dhe:
 - **Asnjë prej individëve me aftësi të kufizuara të anketuar** nuk është shprehur se beson se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
- **2.9%** e vajzave/ grave të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre, përkundrajt **6%** të djemve/ burrave që kanë një qendrim të tillë.

- **Në lidhje me kontrollin mbi financa e grave**, 1 në 2 djem/ burra të anketuar; dhe 1 në 5 vajza/ gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- **20.6%** e djemve/ burrave të anketuar dhe **14.3%** e vajzave/ grave të anketuara besojnë se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** **30%** e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici (Bashkia me % më të lartë për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, **26%** e djemve/ burrave të anketuar dhe **37%** e vajzave/ grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe BGJ

- **Spotet televizive/ emisionet/ debatet (87%), media sociale (68%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (30%), dhe radio (26%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e DHnGV.**

1.5 Profili i Bashkisë Korçë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i **78 individëve** - gra, vajza, burra, djem, të moshave **15 – 64 vjeç**, përgjatë vitit **2020**, në **Bashkinë e Korçës** në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane dhe AK).



Njohja e ligjit/ informacion rreth ligjit/ familjariteti me ligjin

- **82% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore (*Bashkia me % më të lartë* për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim), **95% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **31% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna psikologjike është e dënueshme me ligj.
- **74% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **10% e të anketuarve** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **60% e të anketuarve nga komuniteti Rom/ Egjiptian** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
 - **Asnjë prej individëve me aftësi të kufizuara të anketuar** nuk është shprehur se beson se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
- 1 në 10 vajza/ gra të anketuara (10%) bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre, përkundrajt 18% të djemve/ burrave që kanë një qendrim të tillë.
- *Në lidhje me kontrollin mbi financa e grave*, 1 në 4 djem/ burra të anketuar; dhe 1 në 20 vajza/ gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 12.8% e djemve/ burrave të anketuar dhe 2.6% e vajzave/ grave të anketuara besojnë se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** Vetëm 9% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 21% e djemve/ burrave të anketuar dhe 31% e vajzave/ grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe BGJ

- Media sociale (62%), spotet televizive/ emisionet/ debatet (59%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (22%), dhe radio (15%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e DHnGV.

1.6 Profili i Bashkisë Shkodër mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 118 individëve - gra, vajza, burra, djem, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2020, në Bashkinë e Shkodrës, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, dhe AK).



Njohja e ligjit/ informacion rreth ligjit/ familjariteti me ligjin

- **69% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **86% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **42% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna psikologjike është e dënueshme me ligj.
- **67% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **31% e të anketuarve** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **80% e të anketuarve nga komuniteti Rom/ Egjiptian** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
 - **Asnjë prej individëve me aftësi të kufizuara të anketuar** nuk është shprehur se beson se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
- 1.7% e vajzave/ grave të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre, përkundrajt 27% të djemve/ burrave që kanë një

qendrim të tillë (*Bashkia me hendekun më të madh ndërmjet përgjigjeve të vajzave/ grave dhe djemve/ burrave për këtë tregues*, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).

- Në lidhje me kontrollin mbi financat e grave, 1 në 2 djem/ burra të anketuar; dhe 1 në 7 vajza/ gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 22% e djemve/ burrave të anketuar dhe 3.4% e vajzave/ grave të anketuara besojnë se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** 20% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 14% e djemve/ burrave të anketuar dhe 29% e vajzave/ grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe BGJ

- Media sociale (63%), spotet televizive/ emisionet/ debatet (61%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (30%), dhe radio (10%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e DHnGV.

1.7 Profili i Bashkisë Tiranë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i **457 individëve** - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave **15 – 64 vjeç**, përgjatë vitit **2020**, në **Bashkinë e Tiranës**, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, AK, dhe personave LGBTI).



Njohja e ligjit/ informacion rreth ligjit/ familjariteti me ligjin

- **71% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **75% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **50% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna psikologjike është e dënueshme me ligj.
- **53% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet (*Bashkia me % më të ulët* për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).

Perceptimet e roleve gjinore

- 49% e të anketuarve besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **76% e të anketuarve nga komuniteti Rom/ Egjiptian** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
 - **60% e individëve me aftësi të kufizuara** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
- 1 në 3 vajza/ gra të anketuara (35.9%) bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre, përkundrajt 61% të djemve/ burrave që kanë një

qendrim të tillë.

- *Në lidhje me kontrollin mbi financat e grave*, 1 në 4 djem/ burra të anketuar; dhe 1 në 4 vajza/ gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit (*E vetmja Bashki me raport të njëjtë të vajzave/ grave dhe djemve/ burrave* që kanë të njëjtin qendrim për këtë tregues).

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 55.6% e djemve/ burrave të anketuar dhe 29.6% e vajzave/ grave të anketuara besojnë se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet (*Bashkia me % më të lartë* për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** 20% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 15% e djemve/ burrave të anketuar dhe 19% e vajzave/ grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe BGJ

- Media sociale (37%), spotet televizive/ emisionet/ debatet (37%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (29%), dhe radio (24%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e DHnGV.

1.8 Profili i Bashkisë Vlorë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 114 individëve - gra, vajza, burra, djem, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2020, në Bashkinë e Vlorës, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane dhe AK).



Njohja e ligjit/ informacion rreth ligjit/ familjariteti me ligjin

- **32% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore (*Bashkia me % më të ulët* për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim), **54% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje (*Bashkia me % më të ulët* për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).
- **28% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna psikologjike është e dënueshme me ligj.
- **71% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **5% e të anketuarve** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë/ burrat duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **10% e të anketuarve nga komuniteti Rom/ Egjiptian** besojnë se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
 - **Asnjë prej individëve me aftësi të kufizuara të anketuar** nuk është shprehur se beson se vajzat/ gratë i përkasin sferës shtëpiake.
- Asnjë prej vajzave/ grave dhe djemve/ burrave të anketuar nuk është përgjigjur se bie dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre.
- Në lidhje me kontrollin mbi financat e grave, 2% e djemve/ burrave të anketuar; dhe 2% e vajzave/ grave të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- Asnjë prej vajzave/ grave dhe djemve/ burrave të anketuar nuk është shprehur se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet (*E vetmja bashki me 0% të të anketuarve* që nuk besojnë se vetëm dyshimi për tradhëti është një “arsye e mirë” për të ushtruar dhunë ndaj partneres).
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** Vetëm 2% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici. (*Bashkia me % më të ulët* për këtë tregues, në raport me zonat e tjera të përfshira në vlerësim).

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara,** asnjë prej djemve/ burrave të anketuar dhe 29% e vajzave/ grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI. (*E vetmja bashki me 0% të djemve/ burrave të gatshëm për parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI*).

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe BGJ

- Spotet televizive/ emisionet/ debatet (62%), media sociale (60%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (32%), dhe radio (6%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e DHnGV.

II. TË DHËNAT CILËSORE TË VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR MBI PROGRAMET E ZBATUARA NË FUSHËN E BGJ, DHnGV DHE DHF PËRGJATË VITEVE 2017-2020

2.1 Grupet e synuara

Në përgjithësi programet e zbatuara nga organizatat apo institucionet e intervistuar në fushën e çështjeve të BGJ, DHnGV dhe DHF në vend, kanë si grupe kryesore të synuara:



- vajzat dhe gratë:
 - o e dhunuara, të mbijetuara nga DHF
 - o në zonat rurale
 - o kryefamiljare dhe në skemën e ndihmës ekonomike
 - o punonjëse të sektorit fason
- burra dhe gra;
- të rinjtë;
- anëtarë të komunitetit;
- punonjësit e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit kundër DHF dhe dhunës me bazë gjinore:
 - o administrata qendrore dhe vendore
 - o nëpunësit gjinorë në bashki
 - o anëtarët e Mekanizmave të Koordinuar të

Referimit në bashki

- ofruesit lokalë të shërbimeve;
- organizatat lokale të shoqërisë civile që veprojnë në mbrojtje dhe në ofrim shërbimesh për personat e dhunuar.

2.2 Kanalet e informacionit

Përdorimi i mediave të ndryshme është përmendur si një ndër kanalet më të vlefshëm të informacionit. Përfaqësuesit e organizatave dhe institucioneve deklaruan se përdorin *median sociale* (facebook, Instagram, twitter), *median vizive* (kanalet televizive kombëtare, publike dhe lokale) dhe *median audio* (radio). Media sociale ka një ndikim të madh për arritjen e rezultateve gjatë zbatimit të programeve, për shkak të masivitetit dhe lehtësisë në përdorim. Gjithashtu televizioni (sidomos kanalet kombëtare) është një mjet shumë i fuqishëm në përcimin e mesazheve, informimin, ndërgjegjësimin dhe ngritjen e çështjeve për zgjidhje. Disa prej organizatave e kanë shfrytëzuar më së miri këtë mjet duke përcjellë mesazhet në një audiencë më të gjerë nëpërmjet lidhjeve direkte në studio të ndryshme televizive.

Të gjithë organizatat dhe institucionet përdorin *faqen zyrtare të internetit (website)* si kanal të përhershëm komunikimi të mesazheve dhe të aktiviteteve të tyre. Faqja zyrtare e internetit ka shërbyer si një kanal informacioni në të cilën janë publikuar:

- raporte dhe dokumente të ngjashme, si një bazë e mirë të dhënash dhe informacioni në lidhje me dhunën në Shqipëri, raportimin, trajtimin dhe shërbimet e ofruara për personat që dhunohen.
- spote, video, të realizuara në fushata të ndryshme për BGJ, DHnGV dhe DHF.



2.3 Metodat/ mjetet e përdorura

OJF-të e intervistuarat kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme në kontakt me strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit kundër DHF dhe dhunës me bazë gjinore dhe kanë lobuar për përmirësimin e praktikave dhe minimizimin e problematikave të konstatuara.

Metodat e përdorura janë të shumëllojshme dhe gjykimi mbi suksesin e tyre bëhet në varësi të qëllimit. Për shembull në lidhje me përmirësimin e legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore dhe DHF, instrumenti më i suksesshëm i OJF-ve ka qenë **lobimi dhe advokacia** në lidhje me të. Konkretisht, organizatat kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm sa i përket ndryshimeve të Ligjit nr.9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënjet familjare”, i ndryshuar (viti 2018 dhe 2020) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjit nr.10221 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me ligjin nr.124/2020. Nëpërmjet lobimit dhe advokacisë, nevojat dhe interesat e vajzave dhe grave të dhunuara janë sjellë pranë vendimmarrësve dhe politikëbërësve. Për këtë arsye, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim - GADC (një prej organizatave zbatuese në këtë program rajonal) ka realizuar seanca dëgjimore pranë komisioneve në Parlamentin Shqiptar.

Shpërndarja e informacionit konsiderohet themelore në fushatat informuese dhe ndërgjegjësuere të realizuara online, si dhe gjetjet e rekomandimet nga raporte të ndryshme. Një nga mënyrat më interesante të shpërndarjes së informacionit është nëpërmjet **videove me mesazhe ndërgjegjësuere**, që godasin menjëherë në audiencë, dhe ka mënyra të ndryshme online për shpërndarjen e tyre. Hartimi i **fletëpalosjeve** me informacion konkret se ku mund të kërkohet ndihmë në situatat e dhunës; si dhe vendosja e tyre në vende publike (farmaci, supermarkete, parukeri, qendra shëndetësore, institucione etj) është konsideruar si një mjet mjaft efikas dhe praktik.

Ndër metodat më të zakonshme të shpërndarjes së informacionit janë edhe **trajnimet, seminarët, workshopet** me target grupe të ndryshme (nxënës, mësues, prindër, vajza, gra, djem, burra, të rinj, anëtarë të grupeve të marxhinalizuara dhe vulnerabël, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për BGJ, DHnGV dhe DHF etj).

Ndërthurja mes **takimeve ndërgjegjësuere, përdorimit të kanaleve mediatike dhe ofrimit konkret të shërbimeve** përben një instrument të fuqishëm zgjidhjeje për situatat e dhunës. Përsa i përket vitit 2020, **platformat online dhe rrjetet sociale** kanë qenë një instrument shumë i rëndësishëm për zbatimin e programeve që kanë patur në fokus BGJ, DHnGV dhe DHF.

Po ashtu, një instrument mjaft i rëndësishëm konsiderohet **koordinimi i aktiviteteve për BGJ, DHnGV dhe DHF nën një slogan**, duke përdorur shenjat dalluese me ngjyrën simbol portokalli, si dhe **duke angazhuar të rinjtë**.

2.4 Monitorimi dhe vlerësimi i programeve

Programet e zbatuara nga organizatat dhe institucionet e përfshira në këtë vlerësim, i nënshtrohen një procesi monitorimi të brendshëm dhe/ose të jashtëm.

Zakonisht, që në fazën e ndërtimit të një programi planifikohen dhe rezultatet e synuara dhe indikatorët e matjes së këtyre rezultateve. Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i programeve është i rëndësishëm për matjen e impaktit në komunitet dhe target grupet që programet kanë në fokus. Monitorimi dhe vlerësimi i çdo programi/ projekti, në përgjithësi është pjesë e **raportimit të vazhdueshëm tek donatori**, si dhe/ ose



pjesë e raporteve vjetore të organizatave dhe institucioneve. Në rastet kur nuk ka monitorime apo vlerësime të jashtme, organizatat bëjnë monitorimin e tyre, si pjesë e analizës së punës së bërë dhe matjes së performancës.

Gjithashtu, *organizatat dhe institucionet realizojnë dhe raporte monitorimi të funksionimit të mekanizmave të BGJ, DHnGV dhe DHF*. Institucionet shtetërore çdo vit hartojnë një raport monitorimi në kuadër të zbatimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore (SKBGJ) për periudhën 2016-2020, ku për çdo fushë nxirren problematikat dhe sfidat për të ardhmen. Sipas raportit të monitorimit të SKBGJ për objektivin 3.1. *ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje*, rezulton se:


- Në fund të vitit 2020, numri i individëve të shoqërisë sonë të cilët besojnë se dhuna me bazë gjinore dhe DHF janë të papranueshme dhe të patolerueshme, është rritur me 30%.

Sa i takon monitorimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër DHF dhe asaj me bazë gjinore, për vitin 2020 janë realizuar raportet në disa bashki të Shqipërisë (rasti i GADC), konkretisht:

- Statistika mbi monitorimin e objektivit të III të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020 (<https://bit.ly/37Bjtk9>)
- Situata e vazhdeve e grave punonjëse në sektorin fason gjatë pandemisë “Covid-19” (<https://bit.ly/3aE5yvC>)
- Perspektiva gjinore mbi rreziqet socio-ekonomike në kohën e koronavirusit në Shqipëri (<https://bit.ly/2ZPzRcN>)
- Analiza e Shtetit të Shqipërisë GBWN (<https://bit.ly/2NK1ykg>)
- Monitorimi i punës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit gjatë periudhës pandemike Covid-19 në bashkitë Durrës, Elbasan, Fier, Kamëz, Korçë, Lezhë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Vlorë, Tiranë (<https://bit.ly/2NHPiRk>)

2.5 Eksperiencia nga zbatimi i programeve gjatë pandemisë globale Covid-19 (viti 2020)

Pandemia globale e Covid-19, sikundër në çdo fushë tjetër, ndikoi dhe në zbatimin e programeve për BGJ, DHnGV dhe DHF, duke përshtatur mënyrën e realizimit të tyre në përputhje me situatën e krijuar. Pandemia globale krijoi një situatë tepër të vështirë për t’iu përgjigjur në mënyrë të menjëhershme dhe për të koordinuar rastet e DHF.



Policia e shtetit ka ndërmarrë disa masa për të mbajtur në kontroll, minimizuar dhe parandaluar përshkallëzimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, sidomos në kushtet e vetëizolimit gjatë muajve mars dhe prill 2020, por dhe në vijim.

Me qëllim, mbështetjen dhe sigurimin e mbrojtjes ndaj viktimave të DHF, si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve të dhunës, që në fillimet e kufizimit të lëvizjes së qytetarëve, policia ka marrë masa të veçanta për trajtimin e rasteve të DHF. Për këtë arsye, është hartuar dhe dërguar strukturave vendore të policisë, Plani i veprimit nr. 2112, datë 18.03.2020, “Për masat që duhet të merren nga strukturat e Policisë së Shtetit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, për vitin 2020”, i

cili parashikon masat, që do të ndërmarrin strukturat e policisë, me qëllim parandalimin, reduktimin dhe trajtimin me profesionalizëm të rasteve të DHF, mbrojtjen e viktimave dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve të saj gjatë vitit 2020. Gjithashtu, në këtë Plan Veprimi parashikohen masa edhe në

drejtim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit më institucionet e tjera dhe organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në këtë fushë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i ka dërguar të gjithë strukturave vendore të policisë, Letër Porosi Nr.2192, datë 25.03.2020 “Për vlerësimin maksimal dhe shtim të vëmendjes ndaj rasteve të dhunës në familje, gjatë kohës së kufizimit të lëvizjeve dhe zbatimit të masave për parandalimin e përhapjes së Covid- 19”, ku ndër të tjera u parashikua marrja e masave si vijon:

- Rritja e vëmendjes, vlerësimi maksimalisht, si dhe bashkëpunimi i strukturave vendore të policisë me strukturat përkatëse në Bashki, për referimin e çdo rasti të dhunës;
- Marrja në konsideratë dhe vlerësimi i çdo telefonate për DHF nga sallat e komandimit duke njoftuar menjëherë strukturën përkatëse, sipas procedurave standarde të punës, për trajtimin e DHF;
- Shtimi i vëmendjes në terren nga shërbimet e policisë, marrja menjëherë në mbrojtje e viktimës dhe njoftimi i strukturave të policisë që trajtojnë rastet e DHF;
- Dhënia e masave mbrojtëse nga Gjykata në përshatje me situatën e viktimës së dhunës.

Në lidhje me masat e ndërmarra në nivel qendror:

- Strehimi në strehëzat emergjente dhe ato afatgjata pati vështirësi deri në momentin e hartimit të një protokollit specifik përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) mbështetur nga UN Women, i cili u erdhi në ndihmë profesionistëve për mënyrën e veprimit gjatë pandemisë;
- Forcimi i kapaciteteve u realizua nëpërmjet formave të reja, si takimet nëpërmjet platformave online. Forma e re e organizimit të takimeve nëpërmjet platformave online ofroi lehtësi në komunikim, por edhe vështirësi në menaxhimin e kohës, kushtëzuar dhe nga burimet njerëzore të limituara. Gjithashtu përdorimi i platformave online shpeshherë nxori më në pah vështirësitë e krijuara nga mungesa e internetit apo përthithja e informacionit jo në nivelet e duhura. Gjatë kësaj periudhe, shkëmbimi i informacionit ka patur vështirësitë e veta dhe si rezultat i infektimit të profesionistëve dhe nëpunësve nga Covid-19.

Në lidhje me zbatimin e programeve nga OJF-të, ofrimi i shërbimit psiko-social dhe ligjor nga organizata Forumi i Gruas Elbasan (FGE), u bë nëpërmjet linjës telefonike dhe rrjeteve sociale. Në bashkëpunim me qytetarë, OJF-të dhe pushtetin vendor, vajzat dhe gratë në situatë emergjente u pajisën me pako ushqimore dhe higjienike dhe i'u siguroa pagesa e qerasë për disa muaj me qëllim largimin nga banesa ku u gjenden të detyruara të jetojnë/ karantinohen së bashku me dhunuesit. OJF-të kanë përshtatur zhvillimin e aktiviteteve sipas protokollit anti covid ose i kanë realizuar ato online. Në këto rrethana, një nevojë e identifikuar është forcimi i kapaciteteve për konvertimin e aktiviteteve online, si dhe përdorimin e platformave online.

Sipas të dhënave të organizatave dhe institucioneve pjesëmarrëse në këtë vlerësim, ***Covid-19 ndikoi në rastet e raportuara për DHnGV dhe DHF,*** si më poshtë:

- Sipas të dhënave të Policisë së Shtetit, për 4-mujorin e parë të vitit 2020, janë marrë dhe trajtuar gjithsej 612 telefonata për DHF. Gjatë periudhës së izolimit mars- maj 2020 shifrat e denoncimit nuk kanë treguar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Sipas të dhënave të FGE, ka pasur një rritje me 30% të përfitueseve që kanë kërkuar ndihmë dhe këshillim gjatë kësaj periudhe.
- Sipas të dhënave të GADC, situata Covid-19 ka ndikuar në mënyrë të ndjeshme në rritjen e rasteve të dhunës në familje, por për shkak të mbylljes dhe izolimit që pësoi vendi, numri i rasteve të raportuara pësoi ulje.
- Sipas të dhënave të Qendrës të Drejtat e Njeriut në Demokraci, ka patur rënie të numrit të raportimeve krahasimisht me të njëjtën përvijë përpara fillimit të pandemisë. Sa i përket trajtimit të rasteve të DHF që kanë raportuar, institucionet përgjegjëse janë angazhuar për trajtimin dhe mbështetjen e tyre, por ka patur mangësi kryesisht sa i përket trajtimit në kohë dhe përmbushjes së nevojave të tyre.

- Shërbimi Kombëtar pa pagesë i Linjës Telefonike për Gratë dhe Vajzat 116 117 përballoi fluksin e shtuar të telefonatave për muajt mars e prill 2020, të cilat rezultojnë të rritura në masën 30% dhe 50% krahasuar me të njëjtët muaj të një viti më parë. Ndërsa në muajin maj 2020 telefonatat u trefishuan.
- Ndërkaq koordinatorët vendorë kundër DHF u ndeshën me vështirësi në referimin e rasteve sidomos në rastet e strehimit në strehëza dhe rastet me probleme të shëndetit mendor. Shpesh është dashur dhe ndërhyrja e MSHMS për të përballuar situatën e krijuar.

Në lidhje me masat e menjëhershme që merr Policia e Shtetit në cdo rast që konstaton se është ushtruar DHF gjatë një fatkeqësie natyrore janë bërë ndryshime në Ligjin 9669/2016 me Ligjin Nr.125/2020, të cilat kanë të bëjnë me pajisjen me Urdhër Paraprak të Mbrojtjes së Menjëhershme gjatë situatave të emergjencës. Ky është një hap i rëndësishëm në funksion të mbrojtjes efektive të personave të dhunuar gjatë situatave të emergjencës. Gjithashtu, policia për të mbrojtur vajzat dhe gratë e ekspozuara ndaj dhunës në një kontekst emergjence, si pandemia e Covid-19 duhet që të bëj:

- Kontroll periodik në banesën e viktimës, sidomos në rastet kur për arsye të ndryshme, dhunuesi dhe viktimja jetojnë në të njëjtën shtëpi;
- Nxjerrje (sipas ndryshimeve të reja në ligj) të dhunuesit menjëherë nga banesa në rastet kur ka dhunë ndaj gruas;
- Këshillim për të dy palët në rastet kur nuk ka dhunë, por debate si zënka familjare;
- Udhëzime specifike për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin të riskut si dhe bashkëpunimit me koordinatorin vendor kundër dhunës në familje në nivel vendor.

OJF-të kanë dhënë kontributin e tyre duke punuar pa ndërprerje në zhvillimin e aktiviteteve dhe ofrimin e shërbimeve për klientët. Organizatat kanë qënë në kontakt të vazhdueshëm me nevojat e rasteve dhe kanë kontribuar në përmbushjen e tyre në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse. Qendra Liliun ka trajtuar 25 raste të vështira të dhunës seksuale gjatë vitit 2020 (ku gati 80% kanë qënë të mitur/ mitura).

Disa nga nevojat e vajzave dhe grave të dhunuara, që ka sjellë situata e Covid-19 dhe që duhen adresuar për përballimin me sukses të situatave të tilla emergjente, janë si më poshtë:

- Shtimi i shërbimeve në të gjithë vendin, sa më pranë vendbanimit dhe lehtësimi i aksesit në to.
- Rritja e afatit të qëndrimit në strehëzat emergjente (psh nga 72 orë që kanë qëndrimin maksimal në të paktën në 7 ditë).
- Gjetja e formave të reja për denoncimin e dhunës në kushtet kur viktimave të dhunës në familje u duhet të jetojnë të izoluar me dhunuesin (psh përdorimi i aplikacioneve të shpejta për njoftimin e policisë apo shërbimeve të tjera).
- Parashikimi i një zëri buxhetor në njësitë e vetqeverisjes vendore (bashkitë) me qëllim përmbushjen e nevojave bazike të këtyre rasteve, si psh mbështetja e grupeve të varfra dhe që pësojnë diskriminim të shumëfishtë (gratë e vajzat me aftësi të kufizuara, rome, të moshuara etj) me ndihma ushqimore dhe higjienike apo mbështetje financiare.
- Fuqizimi i bashkëpunimit mes koordinatorëve vendorë kundër DHF dhe anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe trajtimit të dhunës në familje.
- Në vendimin e Urdhërit për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, të lëshuar për viktimat të cilat rezultojnë në rrezik të lartë për jetën, të përfshihen domosdoshmërit edhe fëmijët e tyre, edhe kur dhuna nuk i ka prekur drejtpërsëdrejti ata.

2.6 Praktikë e suksesshme

Brenda vitit 2020, në të gjithë bashkitë e vendit (61 bashki) janë ngritur mekanizmat e referimit të dhunës.

Ndër praktikat më të suksesshme nga zbatimi i programeve të BGJ, DHnGV dhe DHF, nga organizatat dhe institucionet pjesëmarrëse në këtë vlerësim janë identifikuar:




- Bashkëpunimi me aktorët relevantë si në ofrimin e shërbimeve, ashtu edhe në ndërgjegjësimin e komunitetit për referimin dhe ndërmjetësimin e rasteve të grave dhe vajzave, të dhunuara.
 - Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit kundër DHF dhe dhunës me bazë gjinore pasi impakti i këtyre aktiviteteve ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit sa i përket trajtimit dhe mbështetjes së të mbijetuarave nga dhuna.
 - Shtirja e shërbimeve (informim, referim dhe këshillim psikologjik) në të gjitha bashkitë e qarkut Elbasan, ka rritur ndjeshëm aksesin e përfutueseve, sidomos në zonat rurale në shërbimet e nevojshme për to.
- Përfshirja e të rinjve në debate dhe aktivitete të ndryshme.
 - Përfshirja e medias dhe përhapja e informacionit dhe materialeve sensibilizuese në rrjetet sociale.
 - Komunikimi direkt me gratë dhe vajzat e dhunuara.

Audienat e targetuara kanë qenë të ndryshme duke u bazuar në moshë, gjini apo prejardhje etnike dhe sloganet e fushatave të ndryshme kanë shërbyer për të përcjellë më qartë dhe fortë mesazhin. Puna e vazhdueshme për të ndryshuar sjellje të gabuara të bazuara në stereotipe të dëmshme gjinore ka ndikim real dhe të prekshëm në komunitet. Disa nga **sloganet më të suksesshme** të fushatave për BGJ, DHnGV dhe DHF, të zbatuara në zona të ndryshme janë:

- Babi mos e vrit mamin!
- Bëje botën portokalli
- Brezi i barazisë ngrihet kundër dhunës
- Dashuria është Respekt
- Dëgjo Beso Mbështet
- Equal is Better
- Fund Dhunës me Bazë Gjinore!
- Jo është jo!
- Kur shfaqet dhuna njerëzorja vdes
- Kush të rreh nuk të do!
- Më dëgjo dhe mua
- Mos hesht! Denonco! Raporto!
- Një jetë pa dhunë e drejtë e çdo gruaje
- Shto zërin tënd
- Stop dhunës ndaj gruas
- Unë zgjedh të jetoj pa dhunë

2.7 Sfidat kryesore

Viti 2020 ka qënë i vështirë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia globale e Covid-19 duke pasur impakt në nivel individual dhe të përgjithshëm. Kjo situatë ka penguar ecurinë normale të punës dhe ka diktuar në mënyrë të detyruar ndjekjen e rregullave dhe protokolleve të reja në punë dhe jashtë saj. Tejkalimi i këtyre vështirësive është ngushtësisht i lidhur me përshtatjen e punës dhe aktiviteteve me situatën. Për shkak të situatës së krijuar



nga Covid-19 dhe masave të ndërrmara nga qeveria për mbrojtjen e popullatës, aktivitetet publike janë shtyrë, janë realizuar online ose janë realizuar në terren me një numër të reduktuar personash.

Disa prej sfidave të identifikuar nga zbatimi i programeve në fushën e BGJ, DHnGV dhe DHF janë:

- Mungesa e shërbimeve sidomos në zonat periferike dhe rurale
- Numri i kufizuar i shërbimeve mbështetëse
- Mungesa e informacionit, sidomos në zonat më të largëta
- Nivili i ulët i besimit tek institucionet
- Hezitimi i të mbijetuarave të dhunës për të ndarë historitë
- Mosplanifikimi i mbështetjes së vajzave dhe grave të dhunuara me buxhete specifike nga institucionet përgjegjëse
- Kapacitet i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore për të mbështetur programet e BGJ, DHnGV dhe DHF.

2.8 Ndërhyrjet në të ardhmen në fushën e BGJ, DHnGV, DHF



Ndërhyrjet në të ardhmen në fushën e BGJ, DHnGV dhe DHF, të propozuara nga organizatat dhe institucionet pjesëmarrëse në këtë vlerësim janë:

- Hartimi i një ligji kuadër që të parashikojë të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe mekanizmat mbrojtës.
 - Funksionimi i mekanizmit të BGJ në të gjithë vendin deri tek bashkitë më të largëta.
 - Hapja e sa më shumë strehëzave ku gratë e dhunuara të gjejnë një strehim të përkohshëm. Këto strehëza duhet të kenë gjithashtu programe riintegruese për personat e dhunuar.
 - Rritja e afatit të qëndrimit në strehëzat emergjente.
- Programe rehabilitimi për dhunuesit.
 - Bashkëpunimi i institucioneve me organizatat e shoqërisë civile që janë të specializuara në dhenien e këtyre shërbimeve.
 - Forcimi i kapaciteteve të koordinatorëve vendorë kundër DHF në nivel vendor; anëtarë të mekanizmave të referimit të nivel vendor.
 - Planifikimi në buxhetin e institucioneve vendore i fondeve për përmbushjen e nevojave bazike të të mbijetuarave nga dhuna.
 - Mbështetje e projekteve të organizatave të shoqërisë civile edhe me fonde shtetërore në funksion të ruajtjes së vazhdimësisë së aktivitetit të tyre.
 - Rritja e fokusit në ndryshimin e sjelljeve të gabuara, përveçse në ndërgjegjësim.
 - Përmirësimi i platformave online të gjithë institucioneve publike dhe private që punojnë me vajzat dhe gratë e dhunuara.
 - Gjetja e formave të reja për denoncimin e dhunës në kushtet kur viktimave të dhunës në familje u duhet të jetojnë të izoluar me dhunuesin (psh përdorimi i aplikacioneve të shpejta për njoftimin e policisë apo shërbimeve të tjera).

2.9 Rekomandime për programet e ardhshme

Disa prej rekomandimeve për programet e ardhshme në këtë fushë janë:

- Përmirësimi ose ngritja e platformave online/ databazave digjitale.
- Përfshirja më e gjerë e djemve dhe burrave në fushata ndërgjegjësimi.

- Edukimi ligjor i publikut për çështjet e BGJ, DHnGV dhe DHF.
- Bashkëpunimi mes institucioneve dhe organizatave lokale që njohin mirë komunitetin ku veprojnë.
- Zhvillimi i fushatave të përbashkëta mes organizatave dhe institucioneve të ndryshme.
- Përfshirja e të rinjve në këto fushata.
- Vlerësimi i impaktit të fushatave ndërgjegjëse në komunitet.
- Përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve moderne të komunikimit për shpërndarjen masive të mesazheve.
- Përdorimi i medias dhe rrjeteve sociale për transmetimin e mesazheve tek një audiencë më e gjerë.
- Realizimi i videove mbi eksperiencat më të mira të vëndeve të BE-së për të parë një qasje ndryshe, për të përçuar tek njerëzit historitë njerzore të grave të dhunuara, që kanë thyer tabutë për çështjet e diversitetit gjinor.



III. SHTOJCA A: LISTA E PERSONAVE TË INTERVISTUAR

Nr.	I/ E intervistuar	Organizata/ Institucioni	Data	Mënyra e realizimit
1.	Brunilda Dervishaj	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	19.02.2021	Online
2.	Alma Katragjini	Drejtoria e Policisë së Shtetit	19.02.2021	Online
3.	Lindita Cakoni	Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci	18.02.2021	Online
4.	Gertjana Hasalla	Forumi i Gruas Elbasan	18.02.2021	Online
5.	Mirela Arqimandriti	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim	25.02.2021	Online